



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

## NJOFTIM

**Rasti:** Blerja e disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Me shkresën nr.500 prot., i AK, datë 01.12.2021, “Përqendrimi ndërmjet Volkswagen Aktiengesellschaft dhe disa asete të Automobil-Logistik-Mosolf GmbH”, Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar mbi transaksionin e blerjes së disa aseteve të shoqërisë Automobil-Logistik-Mosolf GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Referuar dokumentit “Marrëveshja e blerjes dhe transferimit për asetet e Automobil-Logistik-Mosolf GmbH”, palët janë:

**Pala Blerëse: Volkswagen Group Services GmbH** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti ofrimin e shërbimeve me kontratë pune, veçanërisht të natyrës teknike dhe tregtare, kryesisht për shoqëritë e Grupit Volkswagen.

Grupi Volkswagen operon në Shqipëri përmes 2 filialeve: Porsche Leasing SHPK dhe Porsche Albania SHPK.

**Pala shitëse: Automobil-Logistik-Mosolf GmbH**, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt aktiviteti: zbatimin dhe ofrimin e shërbimeve për mjetet motorike si p.sh. shërbimet e ruajtjes, magazinimit etj, transporti special i automjeteve të të gjitha llojeve, blerja dhe shitja e automjeteve, si dhe kryerja e të gjithë transaksioneve në Gjermani dhe jashtë saj që lidhen ligjërisht dhe ekonomikisht me aktivitetet e mësipërme. Shoqëria Automobil-Logistik-Mosolf GmbH i përket Grupit Mosolf. Grupi Mosolf është ofrues i shërbimeve të sistemit për industrinë e automobilave në Europë.

**Asetet e Target** ndodhen dhe realizojnë të ardhura vetëm në Gjermani dhe aktualisht janë në pronësi të shitësit Automobil-Logistik-Mosolf GmbH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**